




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	08.07.2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP 03-03/2189/16
PËR/ZA/TO:	znj. Arjeta QEHAJA, Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit në Ndërmarrjen Publike Banesore
CC:	z. Nexhat KRYEZIU Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me automjete transportuese PICK UP për nevojat e NPB-re "

*E nderuara znj. Qehaja ,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Furnizim me automjete transportuese PICK UP për nevojat e NPB-re" me numër prokurimi NPB-16-018-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Furnizim me automjete transportuese PICK UP për nevojat e NPB-re" me numër prokurimi NPB-16-018-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 01.07.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-03-2189/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Furnizim me automjete transportuese PICK UP për nevojat e NPB-re*" me numër të prokurimit: *NPB-16-018-121*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ndërmarrja Publike Banesore.

Ndërmarrja Publike Banesore si Autoritet kontraktues ka përgatitur njoftimin për kontratë e cili njoftim është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 17.06.2016. Agjencia kundër korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar dokumentacionin përkatës para hapjes së tenderit dhe pasi ka trajtuar të njëjtin ka konstatuar faktet si në vijim:

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, Autoriteti kontraktues ka kërkuar që të furnizohet me 2 automjete pick up për nevojat e Departamentit të Mirëmbajtjes. Agjencia pasi ka analizuar kërkesën e njësisë kërkuese dhe dosjen e këtij tenderi, konstaton se Autoriteti kontraktues ka përshkruar specifikimet teknike si në vijim: *Modeli: Ngarkues: 1.6 TDI ose 1.9 TDI, forma e karrocisë: Kombi ku e ka bashkangjitur fotografinë e modelit të Automjetit, vëllimi i motorit: 1598 cm 3 ose 1896 cm 3, fuqia e motorit: 55 KW (75 PS) ose 77 KW (105 PS), pesha pa ngarkesë: 1611 kg: viti i prodhimit prej 2005, gomat 195/65 R 15 91T.*

Specifikimet teknike që duhet t'i kenë këto automjete janë specifikuar nga njësia kërkuese në atë mënyrë që i përshtatën vetëm prodhuesit Volkswagen modeli caddy dhe eliminojnë prodhuesit tjerë. Për më tepër Autoriteti kontraktues në Specifikimet teknike ka bashkangjitur edhe fotografitë se si duhet të duken automjetet ku këto fotografi i përshtatën vetëm këtij prodhuesi.

Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos jenë me vlera fikse, por të caktohet minimumi i kërkesave teknike dhe që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet e tilla. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Agjencia gjithashtu ka vërejtur se Autoriteti kontraktues ka përdorur kritere për dhënie të kontratës të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Në dosjen e tenderit tek pjesa e kritereve për dhënie të kontratës, Autoriteti kontraktues ka përdorur kriterin çmimi më i ulët i peshuar ku si nën kritere i ka caktuar çmimin 70 pikë, vitin e prodhimit 10 pikë, datën e dërgesës dhe periudhën e përfundimit 5 pikë, KM të kaluara 10 pikë.

Sipas Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092, neni 32 paragrafi 6 theksohet decidivisht se " Në rast të kriterit, tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pikë dhe të peshohen

pikët. Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose secilit artikull në mënyrë që Autoriteti kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmimin më të ulët”

Në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratë furnizimi dhe asesi nuk lejohet që të përdoren kriteret e tilla për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues duhet të përcaktohet se a do ta përdor kriterin çmimi më i ulët apo kriterin tenderi ekonomikisht më i favorshëm. Në rast se përcaktohet ta përdor kriterin tenderi ekonomikisht më i favorshëm mund të caktoj nën kritere si : *karakteristikat e cilësisë, kostot operative, të mirëmbajtjes, jetëgjatësisë, karakteristikat funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose shërbimet pas shitjes*. Bazuar në dispozitat e Ligjit për prokurimin publik në asnjë rast nuk lejohet që për kontratat furnizime të përdoret kriteri për dhënie të kontratës çmimi më i ulët i peshuar të konvertohen çmimet në pikë dhe të peshohen pikët.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik, nenin 32 dhe nenin 52 të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t’i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*